



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 90-të, të mbajtur më 04.08.2023, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Denoncimi me numër 12-3346/1 të datës 07.07.2023, **HIDHET POSHT.**

Denoncimi i dorëzuar me provat të dorëzohet për veprim kompetent Drejtorisë së policisë financiare të RMV-së.

Lënda me numër 12-3346 të datës 2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Lënda me numër 12-3346/1 datë 07.07.2023 është formuar në bazë të denoncimit së dorëzuar nga ///. Në denoncim, dyshime për keqpërdorime financiare midis /// dhe ///, për shkak të mospërputhjes së bilanceve të paraqitura në llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve në /// dhe pretendimeve nga blerësit në ///, me gjendjen e vitit///. KSHPK-së i kërkohet shqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Krahas kërkesës janë paraqitur edhe dëshmi.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së denoncimit, KSHPK-ja vlerësoi se lënda nuk ka elemente për veprim kompetent. Autoriteti kompetent që mund të hetojë pretendimet nga denoncimi është Drejtoria e Policisë Financiare të RMV-së, për të cilën raporti i dorëzuar me provat do t'i përcillet këtij organi për veprime kompetente.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv.

Dorëzuar:  
- Arkivi i RMV-së

Përgatiti: Mr. D.D  
Miratoi: N.B

**KOMISIONI SHTETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**

KRYETAR,  
Biljana Ivanovska

